



E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.809/3 Prot.

Tiranë, më 06.06.2024

V E N D I M

Nr. 180, datë 06.06.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 114, datë 23.05.2024, e z. F. Z, kundër Bashkisë Lezhë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *Unë F. Z, jam larguar nga puna për shkak të bindjeve të mia politike të kundërta me ato të Kryetarit të Bashkisë Lezhë sepse unë jam antar i Partisë Demokratike të Shqipërisë që nga viti 1991 e në vazhdim në pozicione drejtuese në këtë parti. Një fakt i tillë njihet publikisht nga kundërshtari dhe më shumë pasi pjesëmarrja aktive, angazhimi personal dhe familjar por dhe për faktin e persekutimit politik që kam patur nga diktatura komuniste para viteve 1990.*

Marrëdhëniet e punës mes meje dhe Bashkisë Lezhë, kanë filluar në datën 01.05.2016 bazuar në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 (Kodi i Punës), i ndryshuar, me pozicion jurist (inspektor) në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit dhe kanë vazhduar deri në datën 18.08.2023, ku jam njohur me urdhrin nr.281, datë 16.08.2023, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak se nuk jam paraqitur në punë për 7 ditë pa njoftuar eprorin.

Fakti qëndron ndryshe, urdhri është shumë abuziv, pasi unë kam njoftuar çdo ditë eprorin me shkrim me protokoll.

¹ Referuar Vertetimit nr. 33, datë 03.04.2023, të Partisë Demokratike, Dega Lezhë vërtetohet se z. F. Z, është anëtar i subjektit politik: Partia Demokratike e Shqipërisë.

Me zëvendësimin e Kryeinspektorit të mëparshëm që ishte prej 4 vitesh në atë detyrë dhe prurjen e Kryeinspektorit të ri, eksponent i rëndësishëm i Partisë Socialiste, ka nisur diskriminimi me izolim në zyrë, presion, shantazh dhe masa administrative të hapura në shkelje të ligjit, me urdhrin e punës, të vetmin dhe të fundit në llojin e tij, në shkelje të rëndë të ligjit dhe më pas urdhrin të largimit nga puna i sipërpërmendur.

Jam ndier i diskriminuar pasi Kryeinspektori në rakordim me Kryetarin e Bashkisë Lezhë, nuk më kanë lejuar të dal për inspektim në terren në ushtrim të kontrollit të territorit siç ma jep, detyron Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 (Për inspektim), i ndryshuar.

Gjatë intervaleve kohore, më kanë ndëshkuar me masa disiplinore pa fakte, aspak proporcionale, pa procedurë dhe në shkelje të hapur të nenit 37 të Kodit të Punës. Më është kërkuar disa herë me gojë, largimi nga puna në të kundërt do të largojmë ne.

Kryetari i Bashkisë Lezhë në një televizion lokal, gjatë intervistës me gazetarin e biznesit është shprehur se F. Z, punonjës i imi, inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit ka qenë drejtues shtabi elektorale për palën kundërshtare dhe unë (ai) si kam thënë gjë, nuk jam marrë me të, ndërkohë që është shumë e padenjë për të ky deklarim, pasi ai kishte rakorduar me Kryeinspektorin dhe kishin nxjerrë urdhrin e punës për mua për ushtrim kontolli në Njësinë Administrative Ungrej, atje ku nuk ndërtohej dhe nuk kishte fare nevojë për kontroll, ndërkohë që ky urdhër ishte në shkelje ligjore.

Ky proces nisi menjëherë pas zgjedhjeve. Në datën 9 qershor del urdhri i punës i Kryeinspektorit, në datën 9 qershor mbahet procesverbali i kontrollit në zyrë, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, po në 9 qershor jepet masa disiplinore. Rakordim i pastër diskriminues. Për çdo gjë që trajtova dhe për dokumente të tjera që unë kam paraqitur, i disponoj me prova të pakundërshtueshme.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe vënien në vend të së drejtës së shkelur.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankuesit për diskriminim lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga ana e Bashkisë Lezhë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 809/1, datë 24.05.2024, Komisioneri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë nga subjekti ankues, si mëposhtme:
 - Shpjegime më të hollësishme në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike, duke dhënë informacion, fakte apo prova se përse mendoni se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet tuaja politike.
 - A i keni ekspozuar publikisht, në çfarë do lloj mënyrë apo mjete, bindjet tuaja politike.
 - Në ankesën tuaj shprehni se këtë çështje po e ndiqni gjyqësisht, në këto kushte, të na vini në dispozicion kopje të kërkesë-padisë të depozituar pranë gjykatës.
 - Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.
2. Në vijim të kërkesës së Komisionerit, pala ankuese depozitoi pranë KMD-së, sipas procesverbalit të datës 03.06.2024, informacion shtesë si dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar.

Pjesë e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi është dhe Kërkesë - Padia drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me paditës: subjektin ankues, z. F. Z, dhe subjekt të paditur, Bashkia Lezhë.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në analizë të kërkesë-padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe që bëhen prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, janë pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga ankuesi, pranë Gjykatës, ndër të tjera, citohet se:

“...Fakti qëndron ndryshe nga informacionet e këtyre shkresave dhe për rrjedhojë edhe urdhri për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është pa shkaqe të justifikuara pasi, në referim të nenit 153 "III", të Kodit të Punës, konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si dhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit

Ky Urdhër është në kundërshtim me nenet 12,13 dhe 17 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurës Administrative respektivisht, parimi i proporcionalitetit; parimi i drejtësisë dhe parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit .

Parimi i proporcionalitetit neni 12 ;

çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interes publik ose të drejtave të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të çënojë interesa legjitime, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

- 1- Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) I nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çënojnë me pak të drejtat apo interesat legjitime të pales; b) I përshtatshëm për të arritur qëllimin parashikuar në ligj; c) në përpjetim të drejtë me nevojat që e ka diktuar atë.*

Parimi i drejtësisë dhe paanësisë neni 13.

- 1- Në ushtrimin e funksionit të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilin krijon marrëdhënie.*

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit neni 17;

- 1- Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.*

Palët që janë në situatë të njëjtë, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.

- 2- Organi publik gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, races, ngjyres, etnisë shtetësisë, gjuhes, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatëzanisë pëkatesisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup veçantë ose për çdo shkak.*

Ky Urdhër është në kundërshtim me nenin 9 pika 2 dhe 6 të Kodit të Punes: Ndalimi i diskriminimit.

Në pikën 2 të Kodit, përfshihen të gjitha ato që janë trajtuar në nenin 17 të K.Pr.Administrative pak më sipër, ndërsa në pikën 6 thuhet “në zbatim të parimit për trajtim të barabartë, të gjithë punëmarrësit dhe çdo grup punëmarrësish duhet të trajtohen me të njëjtin respekt dhe kujdes dhe duhet të respektohen edhe rrethanat e tyre të veçanta.....Urdhëri është i qartë dhe i pastër diskriminues, politik, ndëshkues dhe absolutisht në shkelje të hapur të ligjit nr.9780 datë 16.07 2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar".

Në kërkesë-padinë e depozituar para Gjykatës, citohet ndër të tjera, se, veprimet e ndërmarra nga ana e punëdhënësit kundrejt paditësit F. Z, janë në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore, ku garantohet mbrojtja nga diskriminimi, citohet edhe neni 9 "Ndalim i Diskriminimit", i Kodit të Punës, si dhe nenet 12,13 dhe 17 të Kodit të Procedurave Administrative mbi parimin e proporcionalitetit, drejtësisë si dhe parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit/Bashkia Lezhë, lidhur me largimin e tij nga puna, dhe ka kërkuar dëmshpërblimin përkatës si dhe rikthimin në punë, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Gjithashtu referuar shkresës nr.429/4 prot., datë 12.02.2024 "Deklaratë Mbrojtje" të Bashkisë Lezhë, drejtuar Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në parashtrime ndër të tjera, citohet se:

“...Theksojmë se urdhërat e punës janë në përputhje me Vendimin nr.393, datë 18.07.2022 të Kryetarit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë", janë detyrat funksionale të çdo punonjësi të Bashkisë Lezhë, dhe si rrjedhojë nuk mund të jenë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, drejtësisë si dhe parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, pasi çdo punonjës i Bashkisë Lezhë ka lidhur kontratë pune me vullnet të plotë, për kryerjen e punës në përputhje me detyrat e parashikuara në këtë rregullore. Sa theksuam më sipër, paditësi z. F. Z, në asnjë moment nuk është diskriminuar politikisht, pasi është ngarkuar me punë në përputhje me rregulloren e Bashkisë Lezhë dhe në përputhje me detyrat funksionale për të cilat është punësuar, por konstatohet se paditësi duke mos u paraqitur në punë për një afat më shumë se 7 ditë, ka detyruar Bashkinë Lezhë të ndërpresë marrëdhëniet e punës për shkaqe të justifikuar.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkaku ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë

(pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njej të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).*

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”.*

Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrotjtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për

pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 114, datë 23.05.2024, të z. F Z, dhe deklaroi pushimin e shqyrtimit të saj².

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë³, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 114, datë 23.05.2024, të paraqitur nga subjekti ankues, F. Z, kundër Bashkisë Lezhë, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

² Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 108, date 20.06.2023, nr. 145, datë 26.07.2023, nr. 89, datë 03.04.2024, të Komisionerit.

³ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.